



Datë: 29.05.2025
Numër Protokolli: 3738/2025

A.nr.659/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.659/2025, të datës 15.04.2025, të parashtruar nga ankuesi B.H., kundër organit të punësimit Thesarit të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.659/2025, e datës 15.04.2025, e parashtruar nga ankuesi B.H., kështu që, **detyrohet** Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të shqyrtoj kërkesën e datës 24.01.2025 të parashtruar nga ankuesi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra si në pikën I të dispozitivit.

A r s y e t i m

Ankuesi B.H. (tutje ankuesi) më datë 15.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative ndaj kërkesës së datës 24.01.2025 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 28.04.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Thesari i Kosovës, ndërsa, kjo e fundit më datë 08.05.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2489/2025 të datës 15.04.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për korrigjim të koeficientit e datës 24.01.2025 nga ankuesin për zëvendësuesin e Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit dhe emailin e datës 24.01.2025; Emailin e datës 23.01.2025 nga ankues për Xh.Z; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 28.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 08.05.2025; Akt Emërimit e datës 02.04.2012; Përshkrimin e venit të punës Administrator i Bazë së

të Dhënave të Sistemit të Pagave i datës 20.05.2011'Vendimin me Nr. 23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Raportin e punës së Komisionit për vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se rastin e ankuesit, lënda kthehet në detyrim për vendosje, **sepse**:

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 02.04.2012 është i punësuar në pozitën Administrator i Sistemit të Pagave në Thesarin e Kosovës.

Tutje sipas provave të lëndës Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Vendimit me Nr. 23/165 të datës 12.10.2023 ka aprovuar listën e ekspertëve të kategorizuar sipas shtojës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, e ku sipas raportit të Komisioni për vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike si sisteme strategjike për Thesarin e Kosovës janë pranuar Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK) dhe Sistemi i Menaxhimit të Pagave për Zyrtarët Publik-PSM, rrjedhimisht sipas këtij raporti si pozita të ekspertëve janë kategorizuar Administrator i Lartë i Sistemit B5, Administrator i Lartë i bazës së të dhënave B5 dhe Administrator i Sistemit B6.

Ankuesi më datë 24.01.2025 ka parashtruar kërkesë për korrigjim të koeficientit tek zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, duke kërkuar që kërkesa të adresohet tek Komisioni për vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, me qëllim in që pozita e tij si Ekspert 5 të klasifikifikohet në Ekspert 4, mirëpo që nuk ka marr përgjigje.

Ankuesi kundër heshtjes administrative, ka parashtruar ankesë me pretendimet që të detyrohet zëvendësuesi i Drejtori të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës që kërkesën e tij ta adresoj tek Komisioni për vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike si organ përkatës.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të çështjes ankimore, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj,* si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me kërkesën e datës 24.01.2025 të parashtruar nga ankuesi.*

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se duke marr parasysh faktin se Sistemi i Menaxhimit të Pagave për Zyrtarët Publikë-PSK është pranuar si Sistem Shtetëror i Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, përkatësisht edhe pozita e ankuesit, atëherë bazuar në dhe aktin nënligjor të miratuar gjegjësisht Rregullorja (QRK) Nr. 22/2024 për Ekspertët, respektivisht me nenin 5 paragrafi

1, përcakton se: 1. Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit i cili vlerëson se institucioni është pronar, menaxhon dhe administron sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, ose koordinon funksionimin e këtyre sistemeve, parashtron kërkesë për vlerësim të sistemit tek Komisioni, ndërsa përgjegjësit tjera janë të komisionit përkatës, mbi këtë konstatim Kolegji i Këshillit, vlerëson se zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës është i obliguar të ndërmarr veprimet në raport me shqyrtimin e kërkesës së palës ankuese.

Kështu që thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.659/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.H.;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës; dhe ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.